



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.26/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtarin ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa Anr.26/2017 e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografit e printuara nga vendi i ngjarjes, si dhe një CD. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 31.05.2017, rreth orës 18:30h në rrugën “Ankara” në Prizren, monitoruesi ynë ka hasur në postere të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) të ngjitur në një shtyllë publike dhe në transformatorët e energjisë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik KDTP ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur tri fotografi të printuara si dhe një CD me tri fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017, KDTP, thekson se lidhur me pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe urdhëresës së PZAP-it për të ndërmarrë masa përmisuese, kanë informuar se kandidatët për deputet nga subjekti i tyre politik i kanë larguar posterat në fjalë.

Në cilësinë e provës, përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur foton që e dëshmojnë gjendjen e tanishme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) janë të vendosura në shtyllë publike dhe transformatorët e energjisë elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik KDTP, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet nga ky subjekt politik janë vendosur në objekte publike, si dhe nga përgjigja e ofruar nga subjekti politik KDTP nuk është mohuar shkelja e lartcekur, mbi këtë bazë paneli konsideron se subjekti politik i lartcekur ka kryer vepra penale të kundërligjshme të parapara në nenin 33.b e LZP-së.

Paneli e urdhëroi subjektin politik, KDTP, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik KDTP, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik KDTP, janë vendosur në rrugë dhe objekte publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit në fjalë që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.26/2017 më datën 05.06.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Kwshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.